



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

SHTYLLA IV

BASHKIMI EUROPIAN DHE INTEGRIMI

*E ardhmja e politikave monetare europiane**MsC. Sajmira Kopani*

I. ABSTRAKT

Europa e Bashkuar filloi një epokë të re me traktatin e Mاستrihtit, pasi ky i fundit shënon triumfin e një sërë arritjesh si në lëmin ekonomik dhe atë politik. Krijimi i tregut monetar dhe përgatitja për hedhjen në qarkullim të monedhës së përbashkët shënoi kulmin e integritit ekonomik dhe përsosjen e tregut të vetëm. Integrimi ekonomik i BE-së përmes formave të promovuara nga Traktati i Romës dhe më pas ai i Mاستrihtit synon rritjen ekonomike të shteteve anëtare dhe njëkohësisht forcimin e Bashkimit European si konkurrent në tregjet globale.¹ Për të plotësuar nocionin e tregut të vetëm evropian, Traktati i Mاستrihtit parashikoi Kriteret e Konvergjençës për praninë në Bashkimin Monetar European. Ky i fundit thuhet se është maksimumi i integritit evropian dhe se është një eksperiment shumë i madh (Van Veen, 2002). Kjo është arsyeja pse është interesante të diskutohet në lidhje me historinë e tij, legjitimitetin, kostot, dhe të ardhmen.² Pas krizës (Globale) financiare të 2008-ës dhe asaj të 2010-ës që preku Eurozonën, rregulloret për politikën monetare europiane janë shumëfishuar dhe madje kanë ndërhyrë edhe në rregullimin e aspekteve fiskale. Këto rregullore evidentojnë se integrimi për sa u përket këtyre politikave është thelluar dhe ky integrim është parë si një teori që mund të ndihmojë parandalimin e krizave në të ardhmen.

FJALË KYÇE: Politika Monetare e Bashkimit European; Kriza ekonomike; Pakti për Stabilitet European; Mekanizmi për Stabilitet Financiar

SHKURTIMET

BE/BASHKIMI	Bashkimi European
BQE	Banka Qendrore Europiane
GDP	Produktit të Përgjithshëm Bruto
GJD	Gjykata Europiane e Drejtësisë
KEA	Komiteti Ekonomik Aziatik krijuar nga Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore
LSFE	Lehtësuesi për Stabilitet Financiar European
MSF	Mekanizmi për Stabilitet Financiar
MTAV	Marrëveshja Tregtare në Amerikën e Veriut

¹SHBA-ës kanë ndihmuar në krijimin e tregut të lirë dhe tregu i saj i brendshëm është marrë si model për tregun e përbashkët. Plani Marshall gjithashtu kishte si qëllim që pas Luftës së II Botërore të rriste ekonominë dhe tregëtinë e lirë me BE-në.

²Milica Stanković, 2013, "The advantages of being a member of the european monetary union and its influence on trade in the eurozone", fq 3, available at: <http://www.vps.ns.ac.rs/SB/2013/2.3.pdf>.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

NEK	Norma Europiane e Këmbimit
OMT	Transaksionet e Huaja Monetare
PRS	Pakti për Rritje dhe Stabilitet
PSE	Pakti për Stabilitet European
SME	Sistemi Monetar European
SEBQ	Sistemi European i Bankave Qendrore
TBE	Traktati i Bashkimit European
TFBE	Traktati i Funkcionimit të Bashkimit European

II. ZHVILLIMI HISTORIK I BASHKIMIT MONETAR EUROPIAN

Lëvizjet e para drejt bashkimit monetar european filluan gjatë ditëve të fundit të sistemit të kursit të këmbimit “*Bretton Woods*”, në fillim të viteve 1970. Në sistemin e dollarit, i cili filloi pas Luftës së Dytë Botërore, monedhat e të gjitha vendeve të mëdha industriale kishin një çmim të caktuar me referencë dollarin. Ndërkohë që dollari, kishte një çmim fiks prej 35\$ për kub ari. Ky sistem shërbente edhe për përcaktimin e normave të këmbimit midis monedhave europiane. Rënia e sistemit “*Bretton Woods*” hapi derën për norma dypalëshe të shkëmbimit që përcaktoheshin nga forcat e tregut dhe jo me dekret të qeverisë ose me ndonjë akt të ngjashëm ekzekutiv (ligjor). Duke marrë shkas edhe prej kësaj situatë, një komitet i kryesuar nga Pierre Werner, kryeministër dhe ministër financash i Luksemburgut, filloi punën në vitin 1970 dhe doli me një raport në të cilin u propozuan norma fikse këmbimi mes shteteve të BE-së dhe krijimi i një sistemi të federuar të bankave qendrore europiane. Ky raport u miratua nga Këshilli i Europës në mars të vitit 1971.

Një përpjekje më e plotë për një sistem të kursit të këmbimit për Europën, ishte krijimi i Sistemit Monetar European (SME), i cili filloi në mars të vitit 1979, ku tetë nga nëntë anëtarë të Komunitetit European (të gjithë përveç Britanisë së Madhe) u bënë pjesë e mekanizmit *Norma Europiane e Këmbimit* (NEK). Në atë periudhë normat e inflacionit në shtetet pjesë të NEK-së, ishin të larta³ dhe me kufij të ndryshëm⁴. Këto dallime të inflacionit e kanë bërë të vështirë ruajtjen e stabilitetit në NEK, ku me një kurs këmbimi fiks diferenca në inflacion përkthehej direkt në ndryshime tek çmimet relative, të cilat prishin konkurrencën midis vendeve.⁵

Raporti i vitit 1989 i përgatitur nga komiteti i kryesuar nga Zhak Delors, president i Komisionit European, deklaronte se “*Një treg i vetëm kërkon një monedhë të vetme.*” Akti i Vetëm European bëri thirrje për heqjen e të gjitha barrierave të brendshme në tregti, lëvizjen e lirë të kapitalit dhe

³Norma e lartë e inflacionit është rrjedhojë e hedhjes së pakontrolluar të parasë në treg dhe në të tjera mungesë të mirash materiale apo shërbimesh të cilat reflektohen me rritje të pakontrolluara çmimesh. Nëse një monedhe e huaj do të shkëmbehej me monedhën vendase, ajo do të dilte me humbje të konsiderueshme.

⁴Kufijë nënkuptojnë shkallën e imunizimit ndaj inflacionit, i cili përcaktohet nga institucioni drejtues i politikës monetare kombëtare.

⁵Bordo, Michael dhe Jonung, Lars. 1999, “*The Future of EMU: What Does the History of Monetary Unions Tell Us*”, fq. 6,7.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNALAL ♦ Numri 3 Shtator 2017

të forcës punëtore brenda Europës deri në fund të vitit 1992. Ky Akt ishte një tjetër hap në drejtim të integritimit ekonomik europian, i cili filloi me Traktatin e Romës.⁶ Traktati i Mاستrihtit, i nënshkruar në fund të vitit 1991, caktoi një afat kohor për këtë proces, konkretisht parashikoi se monedha e përbashkët do të hynte në qarkullim jo më vonë se 1 Janari 1999.

III. KUADRI LIGJOR I POLITIKËS MONETARE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në preambulën e Traktatit të Bashkimit Europian parashikohet se shtetet themeluese ishin: “TË VENDOSUR për të arritur forcimin dhe konvergencën e ekonomive të tyre dhe për të krijuar një union ekonomik dhe monetar, duke përfshirë, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati dhe të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Europian, një monedhë të vetme dhe të qëndrueshme...”. Nga ky parashikim rrjedh se një ndër qëllimet që Bashkimi Europian i ka përcaktuar vetes është: “...themelimi i unionit që do të bazohet në rritjen e balancuar ekonomike dhe stabilitetin e çmimeve si dhe krijimi i një ekonomie të tregut social me konkurrueshmëri të lartë...”, qëllim i cili bëhet më i arritshëm dhe i menaxhueshëm me aplikimin e një monedhe të përbashkët.⁷

Monedha e përbashkët ka një rol domethënës edhe për dimensionin e identitetit europian. Ajo ka qenë gjithmonë një simbol në përpjekjet për krijimin e kombeve.⁸ Ky efekt rritet shumë me lidhjen e drejtpërdrejtë që kanë qytetarët me monedhën gjatë përditshmërisë së tyre dhe ndihmon në krijimin e një sensi përkatësie. Dizenjimi i monedhave anashkalon çdo simbol të liderëve, intelektualëve, artistëve më të njohur kombëtar dhe na serviret me një paraqitje abstrakte ku paraqiten nga njëra anë ura që simbolizojnë ndërlidhjen mes shteteve dhe nga ana tjetër dritare, dyer të shumëfishta që simbolizojnë hapjen ndaj njëri-tjetrit dhe bashkëpunimin.⁹ Duke pasur një monedhë të vetme, Europa bëhet edhe më e bashkuar, njerëzit lëvizin më lehtësisht pa këmbyer monedhat, ndjehen më të sigurt për investimet dhe kursimet e tyre dhe krijohen lehtësira për bizneset, pavarësisht se kriza i dha goditje edhe këtij aspekti.¹⁰ Për më tepër fakti që Bashkimi Europian është i ndarë në vendet brenda Eurozonës dhe ato jashtë Eurozonës mund të jetë një faktor destruktiv për identitetin e përbashkët Europian.¹¹ Gjithsesi monedha e përbashkët është

⁶Capie, Forrest, 1998, “Monetary Unions in Historical Perspective: What Future for the Euro in the International Financial System”, fq. 74.

⁷TBE Neni 3: Qëllimet e BE-së.

(3) Ai punon për zhvillimin e qëndrueshëm të Europës, mbështetur në rritjen e drejtpeshuar ekonomike dhe qëndrueshmërinë e çmimeve, një ekonomi tregu sociale tejet konkurruese, duke synuar punësimin e plotë dhe përparimin shoqëror si dhe një nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimi të cilësisë së mjedisit. Ai nxit përparimin shkencor dhe teknologjik.

⁸Risse Thomas, 2003, “The Euro between national and European identity”. Journal of European Public Policy, Vol 10, fq. 9,10.

⁹European Central Bank. Banknotes design, e aksesuar më Janar 2016 në faqen zyrtare:

<https://www.ecb.europa.eu/euro/banknotes/html/index.en.html>

¹¹Schmidt, Vivien A, 2012, “In the light and shadow of the single currency: European identity and citizenship”. Boston University, fq. 5 aksesuar në Dhjetor 2015, në faqen:

<http://blogs.bu.edu/vschmidt/files/2012/06/Schmidt-In-The-Light-And-Shadow-Of-The-Single-Currency-final.pdf>.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 3 Shtator 2017

përjetuar edhe si humbje e një pjese të identitetit kombëtar, pavarësisht ndikimit që mund të ketë pasur në krijimin e një identiteti të ri Europian.¹²

Traktati i Funkionimit të Bashkimit European parashikoi në nenin 3(c) kompetencën ekskluzive të Bashkimit European në politikën monetare dhe përdorimin si monedhë të përbashkët të monedhës 'Euro'.¹³ Qëllimi i një monedhe të përbashkët është të eliminojë riskun e tregjeve të këmbimit, të sigurojë transparencën e çmimeve, dhe të lehtësojë tregtinë dhe transaksionet ndërkuftare.¹⁴ Në nenin 119 (2) TFBE-së, në kreun "*Për politikën ekonomike dhe monetare*", ndër të tjera përcaktohet, zbatimi i një politike monetare dhe një politike të përbashkët dhe të vetme për kursin e këmbimit, objektivi kryesor i të cilave do të jetë ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike në BE, në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë që shkon në përmbushje të një prej qëllimeve të Bashkimit European.¹⁵ Korniza e prezantuar nga kreu "*Ekonomia dhe Politika Monetare e Bashkimit European*" është përkufizuar si "asimetrike".¹⁶ Kjo për shkak se 'shtylla' monetare është shumë më e avancuar sesa 'shtylla' ekonomike. Kompetencat për politikën monetare i janë transferuar Sistemit European të Bankave Qendrore (SEBQ), ndërkohë që politikën ekonomike janë ende të mbizotëruara nga kompetencat e Shteteve Anëtare. Direktiva nr. 2003/223 e Këshillit të Europës¹⁷ nuk i jep të drejta të barabarta çdo guvernatori në Këshillin Qeverisës të BQE-së, (organi vendimmarrës), por parashikon një votim me rotacion. Konkretisht me adaptimin e monedhës euro nga Sllovakia, numri i anëtarëve në Këshillin Drejtues të BQE, e kaloi numrin 21. Neni 10.2 i Statutit të BQE-së parashikon se kur numri i anëtarëve në Këshillin Drejtues do të kalojë 21, çdo anëtar i Bordit Ekzekutiv do të ketë një votë dhe numri i anëtarëve me të drejtë vote do të jetë 15. Për këtë arsye vendet anëtare në eurozonë janë ndarë në dy grupe, bazuar në fuqinë ekonomike dhe financiare të tyre. Për të përcaktuar se cilit grup do ti përkasë secili guvernator është miratuar një listë. Guvernatorët që përfaqësojnë shtetet e renditura në pesëshen me fuqinë më të madhe ekonomike, konkretisht Gjermania, Franca, Italia, Spanja dhe Holanda ndajnë 4 të drejta vote. Të gjitha shtetet e tjera (14) gëzojnë të drejtën për 11 vota.

¹²Besanko, Matthew, 2005, "The single currency and the draft constitution: a crisis for european commonality". Cross-sections, Vol. 1, fq. 4,5.

¹³Neni 3(4) (c) TFBE: Kompetencë ekskluzive: Politika monetare për Shtetet Anëtare, monedha e të cilave është Euro;

¹⁴Duisenberg, W. "*The euro as a catalyst for European integration*". (Speech delivered at the 'One money, one Euregional market' conference, 6 February 2002, Maastricht, European Central Bank).

¹⁵Neni 119(2) TFBE: Krahas, sa më lart dhe sikurse parashikohet nga Traktatet si dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në to, këto aktivitete përfshijnë një monedhë të vetme euron dhe përcaktimin e realizimin e një politike të vetme monetare dhe një politike të vetme për kurset e këmbimit, objektivi parësor i të cilave është ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe, pa e cenuar këtë objektiv, mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike të Bashkimit, në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

¹⁶Fabian Amtenbrink and Jakob de Haan, 2003, "*Economic governance in the European Union: fiscal policy discipline versus flexibility*", fq. 40; Jean-Victor Louis, 2004, "*The Economic and Monetary Union: law and institutions*", fq. 41.

¹⁷Vendimi nr. 2003/223/EC i Këshillit për amendamentin e nenit 10.2 të Statutit të Sistemit European të Bankave Qendrore dhe Statutin e Bankës Qendrore Europiane [Official Journal L 83 of 1.4.2003].



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

Guvernatorët e marrin radhën për të gëzuar të drejtën e votës bazuar në një rotacion mujor. Kriteri thelbësor në të cilin bazohet ky sistem është kontributi monetar për BE-në i vendeve anëtare. Shtetet do të kategorizohen në tre grupe, nga dy që janë aktualisht kur *numri i vendeve në Eurozonë të arrijë 21*. Aktualisht janë 19 shtete anëtare të Eurozonës dhe ndodhemi afër momentit ku shtetet do të humbasin edhe atë pak ndikim që kishin tek politikat monetare, ndërkohë që deficienca demokratike e BE-së rritet paralelisht.

IV. SISTEMI EUROPIAN I BANKAVE QENDRORE

Sistemi European i Bankave Qendrore përfshin bankat qendrore kombëtare dhe Bankën Qendrore të Bashkimit European.¹⁸ Parimi i Pavarësisë së Sistemit European të Bankave Qendrore është shumë i rëndësishëm. Gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave që i janë përcaktuar, ky sistem është i pavarur dhe nuk merr në konsideratë asnjë udhëzim të institucioneve, organizmave apo agjencive të ndryshme, kjo për shkak të fushës delikate që ai mbulon.¹⁹ Megjithatë edhe Këshilli, bazuar në propozimin e Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin European dhe Bankën Qendrore Europiane, mund të miratojë masa për të harmonizuar kostot dhe specifikimet teknike të gjithë monedhave të destinuar për qarkullim, por kjo vendimmarrje është më shumë teknike dhe jo ndërhyrëse në politikat që Sistemi Ekonomik i Bankave qendrore ndërmerr.²⁰

Shkalla e fortë e pavarësisë së Bankës Qendrore Europiane (një element pozitiv sipas opinionit të autorit) nuk barazpeshohet me një procedurë të fortë kontrolli ndaj punës së BQE-së. Mungesa e një mbikëqyrjeje të centralizuar të sistemit bankar në eurozonë ndihmon për të shpjeguar ashpërsinë e krizës bankare në 2007-08.²¹ Pra BQE-ja nuk gëzon të gjitha atributet e një banke qendrore, p.sh i mungon funksioni si huadhënës i fundit direkt; nuk ushtron rolin mbikëqyrës dhe rregullator të një banke qendrore etj. Struktura e Bashkimit Monetar European përbën atë çfarë shumë e konsiderojnë si e meta fatale e tij.²² Kjo situatë u tentua të korrigjohej nga dy programe të mëdha të Bashkimit European: PSE (Pakti për Stabilitet European) dhe Bashkimi Bankar.

PSE u krijua pas ndryshimit të nenit 136 (1) të TFBE-së, i cili parashikon se për të siguruar funksionimin e duhur të bashkimit ekonomik dhe monetar për të gjitha shtetet e Eurozonës: “...

¹⁸Neni 127(1-2) TFBE: Objektivi parësor i Sistemit European të Bankave Qendrore është ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

¹⁹Neni 130 TFBE: Gjatë ushtrimit të kompetencave dhe kryerjes së detyrave dhe detyrimeve që u ngarkojnë Traktatet dhe Statuti i SEBQ-së dhe BQE-së, as Banka Qendrore Europiane, asnjë bankë qendrore kombëtare dhe as anëtarët e organeve të tyre vendimmarrëse nuk kërkojnë ose marrin udhëzime nga institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit, nga qeveria e një Shteti Anëtar apo nga ndonjë organ tjetër.

²⁰Neni 128 TFBE: Shtetet Anëtare mund të emetojnë monedha të euros, në varësi të miratimit të vëllimit të emetimit nga Banka Qendrore Europiane. Këshilli, me propozim të Komisionit dhe pasi konsultohet me Parlamentin European dhe Bankën Qendrore Europiane, mund të miratojë masa për të harmonizuar prerjet dhe të dhënat teknike të të gjitha monedhave të synuara për qarkullim, për aq sa është e nevojshme për të lejuar qarkullimin e tyre pa pengesa brenda Bashkimit.

²¹Grauwe, Paul, 2010, “Behavioral macroeconomics”, University of Leuven, fq. 64-78.

²²Young Terry; McCord Linnea dhe Crawford Peggy, 2014, “The European Debt Crisis – It’s Back”, Academy of Business Research Journal, Vol. 4, fq. 103.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

*Këshilli do të miratojë masa...(a) për të forcuar koordinimin dhe mbikëqyrjen e disiplinës së tyre buxhetore;(b) për të përcaktuar udhëzimet e politikave ekonomike për ta, duke siguruar se ato janë në përputhje me ato të miratuara për të gjithë Bashkimit dhe mbahen nën mbikëqyrje.” Pas krizës, me qëllim zgjidhjen e saj, nëpërmjet nenit 1 të Vendimit 2011/199²³ parashikohet amendimi i nenit 136 të TFBE duke shtuar nenin (3) si më poshtë: “Shtetet Anëtare monedha e të cilave është euro mund të krijojnë një mekanizëm stabiliteti i cili aktivizohet në qoftë se do të jetë i domosdoshëm për të ruajtur stabilitetin e zonës së euros si një e tërë. Dhënia e çdo kredie (ndihme) të kërkuar financiare në bazë të mekanizmit do të bëhet subjekt i kushtëzimit të rreptë.” Ky ndryshim është ankimuar në Gjykatën e Drejtësisë²⁴ (çështja Pringle) e cila nëpërmjet vendimmarrjes së saj e konsideroi atë të ligjshëm, me argumentin kryesor dhe të sforcuar se kjo ishte një kredi dhe jo ndihmë. Ndihma sipas nenit 122 të TFBE, mund t’i akordohet një Shteti Anëtar nëse gjendet në vështirësi ose rrezikohet seriozisht nga vështirësi të mëdha të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose ngjarje të jashtëzakonshme, të cilat nuk i ka në dorë. Debati kryesor në çështjen *Pringle* ishte shtrirja e kompetencave të BE-së në lidhje me politikën ekonomike, duke “i maskuar” politikën ekonomike si politika monetare, gjë e cila bie ndesh me TFBE-në. TFBE-ja, përse i përket politikave monetare, në nenin 3/1(c) thekson se Bashkimi ka kompetenca specifike, ndërkohë për politikën ekonomike, formulimi i nenit 5 (1) pohon se “Shtetet Anëtare i bashkërendojnë politikën e tyre ekonomike në kuadër të Bashkimit Europian...”. Rrjedhimisht politikën ekonomike ende mbahen nga Shtetet Anëtare dhe BE-ja nuk ka asnjë kompetencë, përveç rolit koordinues.*

Objektivi i ndjekur nga ky mekanizëm, i cili është ruajtja e stabilitetit të eurozonës në tërësi, është qartësisht i ndryshëm nga objektivi i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, i cili është objektivi kryesor i politikës monetare të BE-së. Sipas vendimit të çështjes *Pringle* edhe pse stabiliteti i zonës së euros mund të ketë pasoja për stabilitetin e monedhës së përdorur në atë zonë, masat që kanë efekt në politikën monetare nuk mund të trajtohen si të barabarta me ato në politikën ekonomike vetëm me argumentin se ato mund të kenë efekte indirekte mbi stabilitetin e euros.²⁵

Në kuadër të ndryshimit të nenit 136 të TFBE-së u krijua një organizëm ndërkombëtar me qendër në Luksenburg, Pakti për Stabilizim Ekonomik (PSE-ja). Ky organizëm do të sigurojë, kur është e nevojshme, ndihmë financiare në formë kredie për shtetet anëtare të Eurozonës (në cilësinë e debitorëve), në qoftë se ato gjenden në vështirësi financiare, deri në masën prej 500 bilion euro. PSE-ja zëvendësoi dy programe fondesh të cilat ishin parashikuar për një periudhë të limituar kohe “*Lehtësuesin për Stabilitet Financiar Europian*” (LSFE) dhe “*Mekanizmin për Stabilitet Financiar*” (MSF). Momentalisht PSE-ja është përgjegjëse për të gjitha huamarrjet e

²³ European Council Decision of 25 March 2011, amending Article 136 of the Treaty on the Functioning of the European Union with regard to a stability mechanism for Member States whose currency is the euro (2011/199/EU) of the European Union L 91/1.

²⁴ ECJ Case C-370/12 *Pringle kundër Irlandës*.

²⁵ ECJ Case C-370/12 *Pringle kundër Irlandës*, prg 56.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

reja që shërbejnë për të shpëtuar vendet nga kolapsi ekonomik. Ndërkohë që LSFE-ja dhe MSF-ja do të menaxhojnë vetëm huamarrjet e mëparshme nga Irlanda, Portugalia, Greqia.²⁶

Për përballimin e krizës BQE-ja prezantoi edhe programin "*Transaksionet e huaja monetare të BQE-së*" (OMT)²⁷ ku ajo legjitimohej të blinte bono thesari në tregjet dytësore. Gjykata Federale Gjermane, i kërkoi interpretim GJD-së në lidhje me vlefshmërinë e vendimmarrjes së BQE-së mbi OMT-në, ku GJD-ja nëpërmjet vendimit të saj vuri një standard. Kundërshtimi i Gjykatës Federale Gjermane lidhej me faktin se programi i OMT-së nuk ishte miratuar në mënyrë proporcionale siç parashikon neni 5(4) i TBE-së dhe për më tepër nuk ishte hartuar si një akt ligjor, pasi ishte vetëm një deklaratë për shtyp e Presidentit të BQE-së, Z. Draghi, ku ky i fundit shpjegonte mënyrën se si do të funksiononte programi i OMT-së. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës Federale Gjermane, vlefshmëria e tij nuk mund të shqyrtohej nga GJD-ja e cila nuk kishte juridiksion për këto raste. Në lidhje me këtë aspekt GJD-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se një akt për t'u cilësuar i shqyrtueshëm mjafton të jetë i detyrueshëm dhe të sjellë pasoja (efekte juridike pavarësisht formës²⁸ dhe kur bëhet fjalë për një program të përgjithshëm veprimi me karakter detyrues për një subjekt të përcaktuar (detyrimi që ky i fundit të marrë një vendim) dhe kur akti përmban masa që krijojnë të drejta ose detyrime për palët e treta, kriteret e aksesit për shqyrtim gjyqësor duhet të jenë më fleksibël. Kjo për shkak se programet e përgjithshme të autoriteteve mund të kenë forma jotipike dhe mund të jenë të afta të kenë impakt direkt në situatën juridike të personave.²⁹

Sipas vendimit të Gjykatës C-62/14, refuzimi për të pranuar shqyrtimin gjyqësor të kësaj tipologjie vendimesh do të përjashtonte një numër të madh vendimmarrjesh të BQE-së nga shqyrtimi gjyqësor për shkak se këto vendime nuk janë të miratuara formalisht dhe të botuara në fletoren zyrtare.³⁰ Por kjo praktikë mbart edhe rrezikun që t'u hap rrugën institucioneve europiane për t'u qeverisur me masa jo-ligjore, dhe duhet mbajtur parasysh fakti se domosdoshmëria për masa të shpejta nuk është proporcional me mekanizmat dhe procedurat ligjore të cilat duhet të jenë të peshuara mirë dhe të ndjekin ngadalësinë e gjithë procesit.³¹

Për forcimin e rolit mbikëqyrës të BQE-së u krijua Bashkimi Bankar, i cili e parashikon BQE-në përveçse si një partner kryesor në sistem edhe si një mbikëqyrës bankar brenda Eurozonës, por më e rëndësishmja duke e bërë atë *de facto* huadhënës të fundit direkt në bankat europiane në vend të qeverive.³² Me qëllim, lehtësimin dhe ruajtjen e stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe

²⁶ Scheherazade Rehman, 2015, "*The future of EU*", Global Economy Journal, fq 213-230.

²⁷ "*ECB's Outright Monetary Transactions*".

²⁸ Siekmann, Helmut, 2015, "*The Legality of Outright Monetary Transactions (OMT) of the European System of Central Banks*", Institute for Monetary and Financial Stability.

²⁹ ECJ Case C-62/14, Peter Gauweiler dhe të tjerë kundër Deutscher Bundestag, prg. 75.

³⁰ ECJ Case C-62/14, Peter Gauweiler dhe të tjerë kundër Deutscher Bundestag, prg. 89.

³¹ ECJ Case C-62/14, Peter Gauweiler dhe të tjerë kundër Deutscher Bundestag, prg. 115, 122.

³² Schoenmaker, Dirk, 2015, "*Firmer Foundations for a stronger European Banking Union*", aksesuar më Dhjetor 2015 në faqen: http://bruegel.org/wp-content/uploads/2015/11/WP-2015_132.pdf.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

Monetar (BEM), bazuar në nenet 121 dhe 126 të TFBE-së u hartua Pakti për Rritje dhe Stabilitet³³. Ai nuk u respektua nga shtetet dhe kjo mund të ketë ndikuar në ashpërsinë e krizës, e cila do të kishte qenë më e butë në rast se shtetet do t'i kishin mbajtur parasysh dhe kontrolluar normat e tilla si deficitin buxhetor në masën 3% të Produktit të Përgjithshëm Bruto (GDP), borxhin publik në 60% të GDP-së. Në vitin 2011 Pakti për Rritje dhe Stabilitet (PRS)³⁴ u amendua me qëllim që të merrte në konsideratë rrethanat kombëtare të shteteve dhe për të shtuar më shumë arsyetim ekonomik për rregullat që kanë të bëjnë me të. Pasi u parashikua arritja e objektivave afatmesme, Këshillit, brenda kuadrit të mbikëqyrjes multilaterale sipas nenit 121 të TFBE-së, iu dha kompetenca të shqyrtojë objektivin afatmesëm buxhetor të paraqitur nga shteti anëtar përkatës, të vlerësojë nëse supozimet ekonomike në të cilat bazohet programi janë bindëse, nëse rruga drejt objektivit buxhetor afatmesëm është e përshtatshme dhe nëse masat që po merren dhe / ose janë propozuar janë të mjaftueshme për të arritur objektivin afatmesëm gjatë ciklit.³⁵

Mungesa e mekanizmave për vënien në zbatim të politikës fiskale është një arsye tjetër e krizës që pësoi Euro-zona në 2010-tën dhe mungesa e konsolidimit fiskal është rrjedhojë e ruajtjes së sovranitetit kombëtar të secilit shtet në lidhje me fushën e taksave. Legjislacioni për politikat monetare u përmirësua nëpërmjet një grupi rregullash të njohura si *"Six Pack"*. Monitorimin i politikave buxhetore dhe ekonomike është planifikuar të organizohet në bazë të Semestrit Europian dhe detaje të tjera për zbatimin e rregullave të Paktit për Stabilitet Ekonomik përcaktohen në *"Kodin e Sjelljes"*. Kjo u pasua nga *"Two-Pack"* i cili përmirësoi më tej mbikëqyrjen buxhetore në Eurozonë. Bazuar në procedurën e Semestrit Europian, çdo vend që përdor euron duhet t'i paraqesë projekt-buxhetin e tij Komisionit në mesin e muajit tetor. Nëse Komisioni vlerëson se ky projekt-buxhet nuk i përmbush rregullat e monedhës së vetme, ai mund të kërkojë rishikimin dhe ndryshimin etj.

Të gjitha amendimet e bëra në legjislacionin për politikat monetare, strukturore dhe rritja e kompetencave janë të rëndësishme për të adresuar rrënjët e krizave dhe krijimin e kushteve të favorshme për rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e konkurrencës të cilat janë fusha të ndërlidhura me njëra tjetrën.³⁶ Shumë kritikë kanë argumentuar se politikat ekonomike po maskohen si monetare dhe po dalin nga kompetencat ekskluzive të shteteve. Por ka të tjerë që argumentojnë se pas 2008-tës, u vu re se ekonomitë ishin (janë) integruar shumë me njëra-tjetrën dhe shtetet duhen të modifikojnë strukturat e tyre në kontekstin global dhe se kriza e 2008/2010 nuk ishte kriza financiare, por ishte kriza e parë

³³Rezoluta e Këshillit Europian për Paktin e Rritjes dhe Stabilitetit (Amsterdam, 17 Qershor 1997) [Fletore Zyrtare C 236 of 02.08.1997], amenduar.

³⁴Pakti për rritje dhe stabilitet është një grup rregullash të dizajnuara për të siguruar që vendet e Bashkimit Evropian të ndjekin financat e shëndosha publike dhe të koordinojnë politikat e tyre fiskale.

³⁵Rregullorja (KE) nr. 1055/2005 e datës 27 Qershor 2005 e cila amendon rregulloren nr. 1466/97(KE) mbi forcimin e mbikëqyrjes së pozicioneve buxhetore dhe mbikëqyrjen dhe koordinimin e politikave ekonomike.

³⁶Altar, Moisă; Cramer, Alexandru-Adrian dhe Altar-Samue, Adam-Nelu, 2015, *"Sovereign Financial Asset Market Linkages across Europe during the Euro Zone Debt Crisis"*, Romanian Journal of Economic Forecasting –XVIII, fq. 42-44.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

globale. Ky është një argument që mbështet idenë që ekzistenca dhe forcimi i kompetencave të institucioneve ndërkombëtare është një masë e domosdoshme.

V. KOSTOT E BASHKIMIT MONETAR EUROPIAN

Përfshirja në eurozonë përpos qëllimit të mirë të krijimit të kësaj hapësire sjellë kosto për shtetet.³⁷ Arsyeja kryesore është se shteti humbet mundësinë e përdorimit të instrumenteve kombëtare për sa i përket politikës monetare (p.sh. normat e kursit të këmbimit). Kjo problematikë evidentohet sidomos kur ekonomia e vendit pëson goditje asimetrike. Analiza për vlerësimin e këtyre kostove bazohet në kontributin e njohur të Robert Mundell (1961). Po të supozohet se Franca dhe Gjermania preken nga kjo goditje asimetrike dhe specifikisht na pasqyrohet një ulje e kërkesës agregate në Francë dhe një rritje e kërkesës në Gjermani dhe të analizojmë menaxhimin e kësaj krize në të dyja regjimet (bashkimin monetar dhe pavarësi në politikën monetare) kostot do të jenë evidente.

Asnjëri nga shtetet nuk mund ta stimulojë apo kufizojë kërkesën duke përdorur politikën monetare kombëtare, megjithatë ekzistojnë mekanizma alternative të bashkimit monetar evropian si për shembull fleksibiliteti në pagesa ose lëvizja e forcës punëtore. Duhet mbajtur parasysh se lëvizja e forcës punëtore është shumë e kufizuar në Europë veçanërisht për punëtorët e pakualifikuar dhe arsyeja kryesore është ajo e skemave të sigurimit social. Në rast se pagesat dhe çmimet nuk do të jenë fleksibël, lëvizshmëria e fuqisë punëtore do të kufizohet, kostot do të jenë aq të mëdha sa ndoshta shtetet do të pendoheshin që janë anëtare të Eurozonës. Kjo sepse nëse do të ruanin sovranitetin (pavarësinë) për politikën monetare do të mund të përdornin edhe instrumente të tjera si normat e këmbimit, normat e interesit, ndërkohë që bëhen debitor të një monedhe mbi të cilën nuk kanë kontroll.³⁸ Pra humbja e pavarësisë monetare shkakton një ndryshim në kapacitetin e qeverisë për të financuar defiçitin e tyre buxhetor, por kjo nuk i bën vendet e BE-së që të mos kenë kontroll mbi defiçitin e tyre. Institucionet e BE-së përcaktojnë se sa borxh publik mund të kenë dhe sa afat kanë ta menaxhojnë atë. Qëllimi është që shtetet të bëhen më të përgjegjshme në menaxhimin e borxhit publik, tipar të cilin BE-ja e elaboron në programin “Përgjegjësia Sociale e Korporatave”,³⁹ pra synohet ngritja e një mekanizmi që angazhon një program vetë-rregullues. Për më tepër kjo nuk nënkupton se vendet jashtë eurozonës nuk kanë probleme pasi edhe ato përballen me goditjet asimetrike dhe financimi i borxhit nëpërmjet emetimit të parave, me qëllim kapërcimin e situatës, mund të rris nivelin e inflacionit në këto vende.⁴⁰

³⁷Goodhart, 2013, “Lessons for monetary policy from the euro-area crisis”, Special Conference Paper: The Crisis in the Euro area.

³⁸Mongelli, 2008, “European economic and monetary integration and the optimum currency area theory”, Economic Papers 302.

³⁹ “Corporate social responsibility” aksesuar më Janar 2016, në faqen zyrtare: http://ec.europa.eu/growth/industry/corporate-social-responsibility/index_en.htm

⁴⁰Meltzer, Allan H, 1996, “Monetary Union: Benefits, Costs and a Better Alternative”, Carnegie Mellon University, fq. 3,4.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 3 Shtator 2017

VI. E ARDHMJA E POLITIKAVE MONETARE EUROPIANE SIPAS RRYMAVE TEORIKE

Politika monetare europiane është parë në këndvështrime të ndryshme nga rryma të ndryshme mendimi. Rryma ndër-qeveritare bën një interpretim liberal sipas të cilit forca lëvizëse e integritit europian është rënia dakord mes Shteteve Anëtare, vetëm për atë që i shërben interesave të tyre. Politika e përbashkët monetare ka qenë pozitive për sa i takon përfitimit që ato do të kishin, ndërkohë që Pakti për Stabilitet dhe Rritje dështoi sipas kësaj logjike,⁴¹ dhe kjo dëshmohet me amendimet e ndërmarra pothuajse çdo dy vjet për të forcuar efektshmërinë dhe efikasitetin e parashikimeve.

Rryma federaliste arsyeton se politika e përbashkët monetare është faktor thelbësor për një integritim total dhe krijimin e një bashkimi federalist, por analistët argumentojnë se ka një hendek të konsiderueshëm midis sistemit aktual dhe atij të presupozuar si federal. Ky qëndrim mbështetet në disa komponentë të stabilitetit makroekonomik. Së pari, mospasja e një përkufizimi dhe kapaciteteve për aplikimin e rregullave fiskale edhe pas reformës së Paktit për Rritje dhe Stabilitet; gjithashtu mungesa e koordinimit të politikave fiskale mes njëra tjetres dhe mungesa e autonomisë financiare.⁴²

Sipas rrymës neo-funksionaliste autonomia e Shteteve Anëtare ka humbur në favor të institucioneve të BE-së, veçanërisht Komisionit. Kjo evidentohet në dorëzimin e monedhave kombëtare në favor të monedhës *Euro* të rregulluar nga Institucionet qendrore.⁴³ Një ndër neo-funksionalistët më të njohur, Ernst Haas, bazuar në këtë teori, ka parashikuar se politika e përbashkët monetare do të ndiqet patjetër nga politika e përbashkët fiskale. Të pasurit e një monedhe të përbashkët kërkon domosdoshmërisht edhe një kuadër të përbashkët për shpenzimet, pra thellimi i integritit është një domosdoshmëri dhe kriza e vërtetoi këtë. Në fund të 2013-tës u nënshkrua një marrëveshje ndër-qeveritare për *Traktatin Fiskal* nga 25 vende të Bashkimit Europian (të gjitha përveç MB, Republikës Çeke dhe Kroacisë).⁴⁴ Pavarësisht se kjo marrëveshje nuk ka statusin e një rregullorje të Bashkimit Europian, GJD-ja autorizohet të vendos një sanksion (0.1% të GDP-së) ndaj vendit anëtar i cili nuk i përmbush në mënyrë korrekte parashikimet e Traktatit ose dështon t'i bëjë ato pjesë të legjislacionit të brendshëm të detyrueshëm. Pra është evidente se po lëvizet drejt politikave fiskale të përbashkëta.

⁴¹Në vitin 2001, Portugalia ishte e para që tejkaloj kufirin e përcaktuar nga EU's Stability and Growth Pact. Megjithatë, vendet e tjera nga Gjermania në Greqi e pasuan duke i shkelur këto kritere në vazhdimësi dhe duke iu shmangur gjambat. Mesatarisht, shumica e vendeve anëtare ka rezultuar të ketë patur një deficit buxhetor më shumë se dyfishi i 3% të lejuar.

⁴²Afonso, Oscar dhe Alves Rui Henrique "Fiscal Federalism in the European Union: How Far Are We?" (2008) fq. 6-24

⁴³Cooper, Ian, 2011, "The euro crisis as the revenge of neo-functionalism". Euobserver, aksesuar më Janar 2016 në: <https://euobserver.com/opinion/113682>.

⁴⁴"Q&A: EU fiscal treaty to control eurozone budgets", BBC, 2012, aksesuar më Janar 2016 në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-16057252>.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 3

Shtator 2017

Të gjitha masat e marra veçanërisht së fundmi në kuadër të politikave monetare europiane, përpos faktit që e shpëtuan Eurozonën, faktikisht thelluan integrimin e shteteve dhe duket se teoria neofunksionaliste është teoria që jep një shpjegim të arsyeshëm në lidhje me tendencat e procesit të integritit evropian.

VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bashkimi Europian vihet re se po merr një drejtim tjetër, po ikën nga axhenda dhe politikat ferderaliste dhe po e shikon veten gjithnjë e më shumë si një koordinatore të politikave të vendeve anëtare të BE-s dhe të atyre që aspirojnë për t'u anëtarësuar. Kjo evidentohet edhe në politikat e fundit që po ndërmerr, duke iu kërkuar vendeve të BE-së ose atyre kandidatë të përgatisin “*Programe Planifikuese Kombëtare*”, të cilët më parë quheshin “*Programe për Rimëkëmbjen Kombëtare*”. Me anë të këtyre iniciativave BE-ja po jep rekomandime që shtetet të ngrënë programe vetë-rregulluese dhe të përmirësojnë politikat e dështuara. Pra Bashkimi Europian po shkon gjithnjë e më tepër drejt një roli si koordinatore politikash dhe lë hapësira për vetë-rregullim. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe për politikat monetare.⁴⁵ Si rrjedhojë, është e rekomandueshme që Shqipëria, në fazën e negociimit të kapitullit për politikat monetare, me Bashkimin Europian të mbajë parasysh, për aq sa do të jetë e mundur, këtë drejtim të ri të BE-së.

⁴⁵ Terpan, Fabien, 2015, “*Soft Law in the European Union-The Changing Nature of EU Law*”, European Law Journal, Vol. 21, fq. 78-80.